



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 68/2016

Prishtinë, më 20.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Sala Berisha-Shala, Raif Qela, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë, dhe Visar Ymeri, deputet.

Munguan: Glauk Konjufca, Besim Beqaj dhe Fatmir Rexhepi, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha – OSBE; Jeta Xharra dhe Rraman Ramaj –BIRN; Blerta Bejtullahu – EUSK; Dardan Abazi - INDEP; Etleva Malushaj – LVV dhe Fjolla Uka – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.9.2016;
3. Aprovimi i rekomandimeve lidhur me Vendimin e Qeverisë nr. 05/106, datë 25.8.2016, për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC dhe Vendimin nr. 06/106, datë 25.8.2016, për Projektin e Kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika;
4. Aprovimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2016 dhe prioritetet e Komisionit për sesionin vjeshtor 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Blerim Grainca propozoi që si pikë e rendit të ditës të futet “Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare”, pasi që grupi i punës e ka përfunduar punën.

Raif Qela lidhur më rendin e ditës, kërkoi që të diskutohet për “projektligjin për Trepçën”, pasi që ka mbetur vetëm edhe 1 (një) muaj e gjysmë kur kalon afati që “Trepça” të shkojë në likuidim, dhe propozoi që të futet si pikë e veçantë në rendin e ditës për mbledhjen e sotme për diskutim për çështjen e “Trepçës”.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha sa i përket propozimit të z. Grainca, mund ta shqyrtojmë si pikë të tretë të rendit të ditës, ndërsa sa i përket propozimit të z. Qela, tha se këtë çështje e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar edhe në fund të mbledhjes do ta nxjerrim një rekomandim që të kërkohet nga qeveria që t’i përshpejtojë procedurat e miratimit të “projektligjit për Trepçën”.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.9.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 13.9.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare

Kryetari- Tha se pasi që grupi i punës e ka përfunduar shqyrtimin e projektligjit për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, atëherë do ta shqyrtojmë, dhe kërkoi nga z. Blerim Grainca, kryesues i grupit të punës të paraqet raportin më propozim amendamente.

Blerim Grainca- Tha se grupi i punës së pari e ka organizuar dëgjimin publik për Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, ku kanë qenë të ftuar të gjitha palët e interesit që janë të ndërlidhura më zbatimin e Ligjit në praktikë. Gjatë dëgjimit publik janë pranuar të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që mund ta bëjnë ligjin më të zbatueshëm, pastaj grupi i punës është takuar, në të cilin takim kanë qenë edhe përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe industrisë si hartues të Projektligjit për dhënien e sqarimeve të nevojshme. Ai theksoi se grupi i punës i ka hartuar disa amendamente që kryesisht janë më rregullime teknike, dhe pastaj i prezantoi dhe arsyetoi nëntë amendamentet një nga një si vijon:

Amendamenti 1,

Neni 1, paragrafi 1, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 2,

Neni 3, nënparagrafi 1.3, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 3,

Neni 3, pas nënparagrafit 1.9 shtohen dy përkufizime të reja.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 4,

Neni 4, paragrafët 4 dhe 5, rinumërohen.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 5,

Neni 5, paragrafi 8, referenca “paragrafi 3” zëvendësohet me “paragrafi 6”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 6,

Neni 7, paragrafi 1, fjalia “konform nenit 4 ose 5 të këtij ligji” zëvendësohet me “midis shoqërive tregtare në pajtim me nenin 4 të këtij ligji, dhe në transaksionet tregtare midis shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike në pajtim me nenin 5 të këtij ligji.”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 7,

Neni 8, nënparagrafi 1.3. referenca “nenin 4, paragrafi 5 të këtij ligji, nenin 5, paragrafët 3 dhe 5 të këtij ligji” zëvendësohet me “nenin 4, paragrafi 6 të këtij ligji, nenin 5, paragrafët 6 dhe 8 të këtij ligji”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 8,

Neni 11 ndryshohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 9,

Neni 12, paragrafi 2, referenca “nënparagrafi 3” zëvendësohet me “nënparagrafin 2.3”.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.

2. Raporti t’iu procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës.

4. Aprovimi i rekomandimeve lidhur me Vendimin e Qeverisë nr. 05/106, datë 25.8.2016, për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC dhe Vendimin nr. 06/106, datë 25.8.2016, për Projektin e Kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika

Kryetari i njoftoi se në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar gjerësisht për këto dy vendime, ekziston transkripti. Ne kemi trajtuar vendimet dhe jemi marrë vesh se në bazë të transkriptit të formulojmë rekomandimet. Së pari kemi projektin e kompanisë Envidity. Siç po e shihni këtu kemi prezantuar të gjitha brengat të ngritura në komision dhe propozimi është të aprovohet interesi publik për eksplorime, por me disa kushte të cilat janë shumë të qarta dhe rigorozë, të cilat Kuvendi dhe Qeveria obligohen t'i zbatojnë. Mendoj që duke u nisur nga diskutimi që kemi pasur aty, ne kemi absorbuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet në këtë raport, edhe sot ju kisha lutur që të mos i përsërisim ato që i kemi thënë, por të debatojmë rreth konkluzave, eventualisht vërejtjet në tekstin e konkluzave me propozuar diçka, përndryshe nuk mund ta përsërisim diskutimin që kemi pasur sot një javë.

Visar Ymeri- Tha se nuk kam qenë javën e kaluar pasi që nuk jam anëtar i këtij komisioni. Problemi thelbësor me këto rekomandime është që rekomandohet që të miratohet vendimi i qeverisë, pastaj pjesa tjetër e rekomandimeve është krejt në rregull. Domethënë të gjitha këto që kërkohen në rekomandime studimet e fizibilitetit studime të rrezeve të mundshme e me radhë janë në rregull, mirëpo me u miratuar vendimi atëherë ç' kuptim kanë këto? Si mundim ne ta konstatojmë si komision, si Kuvend edhe qysh ka mundur qeveria me konstatuar interesin publik pa i pas këto informata kur të gjitha janë të lidhura me interesin publik, pra ku është ky interes publik në Kosovë? Mendoj që rekomandimet që i shkojnë Kuvendit duhet të kërkohen informata shtesë nga qeveria pa e miratuar vendimin pasi që po u miratua vendimi i qeverisë ka me ju hapur rruga zbatimit të këtyre projekteve, atëherë mos të na sjellin fare studimet e fizibilitetit se ashtu vetëm na tregojnë paraprakisht të keqen që kemi me pësuar dhe mendoj që këtu është lëshim jashtëzakonisht i madh që po kërkohet nga komisioni ta bëjë. Si mund të miratojmë, ose qeveria dje një projekt që praktikisht krejt basenin e thëngjillit të Dukagjinit e vendos në pronësi private edhe për shfrytëzim për qëllim të lëngëzimit në një anë dhe terjes së thëngjillit në anën tjetër. Ne të gjithë, çdo herë, flasim se si duhet t'i shtojmë kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike të bazuara në thëngjill, këtu ka një shpërputhje në mes të asaj që e thotë Qeveria për nevojat energjetike të Kosovës për planin e qeverisë për t'i përmbushur nevojat energjetike të Kosovës dhe në anën tjetër për vendimet që i marrin për thëngjillin e Kosovës, e tash qeveria do të thotë jo këto flasin për basene të Kosovës, ato për të Dukagjinit. Ai shtoi duke thënë se ka pasur më herët diskutime se si mbase duhet të ndërtojmë një termocentral në Dukagjin bashkë me Shqipërinë në mënyrë që furnizimi me energji elektrike dhe unifikimin e tregut ta bëjmë sa më funksional të përdorshëm për ekonominë tona, e kështu me radhë dhe anën tjetër pse qeveria miraton një vendim të tillë pa e sjellë strategjinë për energjetikë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që është premtuar që do të vijë shumë shpejt në të cilin do të aktivizohet rruga përpara? Sa i përket energjisë në Kosovë, e që nënkupton edhe rruga përpara për resurset energjetike që i ka Kosova, pra mendojë që ky vendim natyrisht në formën të cilën është në asnjë mënyrë nuk bënë të kalojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi e ka rastin ta ndalojë këtë projekt shumë keq të përgatitur, jashtëzakonisht të rrezikshëm dhe me potencial në ndikimin jashtëzakonisht të dëmshëm për qytetarët të Republikës së Kosovës dhe tokën e Kosovës në përgjithësi. Prandaj edhe një herë po kërkoj që rekomandimet ose pjesa e parë e rekomandimeve të futet që vendimin Kuvendi e merr pasi që të

ketë informata, ne nuk mund ta konstatojmë interesin publik nëse nuk i kemi këto informata sepse nëse ky projekt ka ndikime të mëdha siç do të ketë ta zëmë për mjedisin në Kosovë atëherë ky nuk është interes publik. Nëse ky projekt e dëmton potencialin ekonomik të Kosovës atëherë nuk është interes ekonomik, nëse ky projekt ua cenon ose ua rëndon jetën banorëve atje që nuk ka gjasë të mos ndodhë një gjë e tillë, natyrisht që nuk është interes publik. Pra, sipërfaqja që ka kërkuar Envidity e kemi potencuar këtu sipërfaqen për hulumtim ajo sipërfaqe është 1/3 e Kosovës. Nëse Republika e Kosovës mbetet në këta kufij që është, nëse zbatohet demarkacioni kjo bëhet edhe më shumë.

Kryetari- Theksoi se duhet t'ua sqarojmë edhe juve edhe opinionit që na nuk po ua aprovojmë sot projektin, as kësaj kompanisë Envidity, as tjetrës. Projektet nuk po aprovohen, po aprovohet eksplorimi i rezervave dhe mundësive. Projektet do të aprovohen kur përfundojnë në qoftë se Envidity dhe Sharcemi konstatojnë se kanë interes atëherë do të kërkojnë licencat për eksplantim, e te licenca për eksplantim do të zbatohen te gjitha këto. Ne mund ta korrigjojmë se para marrëveshjes për eksplantimin duhet me ekzistuar të gjitha këto që i kemi në rekomandime, këto me i dërguar në Kuvend edhe unë jam dakord, por nuk jam dakord me i ndërruar tezat, me politizuar situatën dhe me i mbyllur mundësitë e eksportimit, duhet të jemi realist, janë të dobishme teknologjitë e reja. Ne do t'i shikojmë kostot dhe përfitimet me këto dokumente, në qoftë se i kemi, nuk mund të gabojmë ta rrezikojmë interesin e Kosovës kur të japim pëlqimin për eksplorim. Unë jam dakord që pëlqimi për eksploitim nuk duhet të jepet në asnjë mënyrë pa ekzistuar këto projekte, edhe për këtë e kemi shkëputur, edhe unë jam ndoshta jo vetëm Qeveria po me marr vendim Kuvendi. Mirëpo nuk jam dakord me i ndërruar tezat, nuk jam dakord me i politizuar, nuk jam dakord me i mbyllur derën për investime për eksplorime, studime, qysh të janë mundësit. I lus deputetët e tjerë që të kenë parasysh këtë situatë dhe i lus direkt se ku kanë intervenime në rekomandime përndryshe nuk kemi nevojë me diskutuar.

Raif Qela- Tha se përkundër faktit që kam dyshime të shumta lidhur me këto dy projekte, me vetë faktin se procesi është akoma në fazën eksperimentale gjithkund në botë, nuk është askund në fazën komerciale, duhet të na vë në dyshim se a mund të shkojë çdo gjë në këtë proces si pasojë e saj duke pasur parasysh se që të dy projektet po synojnë të shkojnë pa procedura konkurruese. Për mua ky është problem i vogël, se sa problemet e tjera që dalin se sa si pasojë e asaj se këtu po deklarohet se në emër interesit publik i cili nuk është përcaktuar qartë çka nëse do të ketë pasoja për ambientin. Me një studim të Bankës Botërore është konstatuar që brenda vitit dëmi në ambient i shkaktuar në Kosovë, se dëmi i shkaktuar rreth 222 milionë euro në përgjithësi në Kosovë edhe prej këtyre projekteve edhe prej tjerave. Cili do të jetë mekanizëm i cili neve na mundëson që ta parandalojmë këtë të keqe që në fazë të mëvonshme konstatojmë që do të jetë, kjo është për mua çështja kryesore, cili mekanizëm do të vijë në lojë që ne mund të parandalojmë nëse vazhdon ky projekt dhe shihet se është në dëm të Kosovës. Nëse nuk ka askush sqarim për këtë sot them që mos të nxitojmë. Deri më tani nuk pash ndonjë mekanizëm, nëse dikush merr licencë për eksplorim, duhet me konkurruar në Komisionin e pavarur për miniera dhe minerale dhe jo në Kuvend, mekanizëm për parandalim, në qoftë se konstatohet pas studimeve se mund të ketë pasoja për ambientin. Nëse ky mekanizëm nuk vendoset sot nuk kam si ta votoj këtë.

Muhamet Mustafa sqaroi se kjo është licencë vetëm për eksplorim, licencë për shfrytëzimin në asnjë mënyrë nuk është. Licenca për shfrytëzim është procedurë e re edhe vendim i ri i Kuvendit dhe ai vendim nuk mund të merret pa i pasur këto. Mos të japim supozime që as nuk jemi ekspertë për këto teknologji, duhet t'i marrim vlerësimet nga ekspertët kompetentë. T'i shohim përvojat e vendeve tjera.

Sala Berisha-Shala- Tha se mua po më vjen keq që nuk kam pasur mundësi me qenë në mbledhje kur është debatuar më në detaje për këto dy projekte, këto dy vendime të qeverisë. Sa i përket rekomandimeve që janë propozuar nga komisioni pajtohem plotësisht ndoshta paraprakisht është ajo dilema se mund ta ndryshojnë vendimin e qeverisë këto rekomandime që i kemi dhënë. Ne duhet me e sqaruar një detaj interesant për eksplorim, i themi shqip për hulumtim të mëtutjeshëm të pasurive nëntokësore. Kosova ka njohuri, nuk është i mjaftueshëm hulumtimi deri më tani i pasurive nëntokësore të Kosovës, prandaj ne nuk duhet t'i mbyllim dyert për hulumtim të mëtutjeshëm të këtyre pasurive të cilat më vonë do të përkthehen në zhvillim ekonomik. Sa i përket lejes për hulumtim, nuk besoj që do të ketë efekte mjedisore sepse ato janë hulumtim e më pastaj leja e shfrytëzimit, mbase leja e eksplantimit që po përdoret me këta terma të jashtëm. Këtu besoj që duhet ta kemi vëmendjen shumë edhe Qeveria edhe Institucionet që japin lejet për hulumtim. Natyrisht se efektet do të dalin pas këtij fizibiliteti që u përmend këtu dhe pasojat që do të jenë më tutje. Do të shkojë në bazë të ligjit për miniera dhe minerale dhe të zbatohet strikt ky ligj edhe për leje hulumtimi edhe për leje shfrytëzimi. Ne ligjin e kemi jashtëzakonisht të mirë, mekanizmat institucional që e shikojnë këtë ligj dhe zbatojnë këtë ligj janë në nivelin e duhur. Për mua shtoi ajo është një dilemë tjetër që kemi një sfidë paraprakisht, sfidën shpronësimit, sikurse shpronësimin e tokave të banorëve të Hadës tani për momentin. Kush do ta marrë përsipër shpronësimin e tyre, kjo është shumë e rëndësishme dhe realisht unë ende nuk e kam të qartë, se kamë qenë edhe jashtë, nuk kamë qenë kur janë zhvilluar këto debate. Këto rekomandime i mbështes.

Duda Balje- Unë i mbështes këto propozime rekomandime për hulumtime pasi që është hapi i parë që duhet të bëhet në investime që të flitet, por që të behët diçka. Unë që kam qenë dje në terren edhe që mund të përcjellë këtë interesi kolektiv gjithqysh në këto studime fizibilitetit, është që të konsultohen banorët e vendit ku do të hulumtohet dhe investohet që bisedohet me komunitetin, kur do që duhet të zhvendoset nga ai vend, ne asnjë rekomandim nuk e keni theksuar konsultimet me komunitetin, ndoshta në pikën 4 për konsultime me komunitetin do të thotë që të konsultohen më së shumti nga Ministra e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Unë mund t'ju garantoj që në Kosovë, për asnjë projekt, nuk është konsultuar komuniteti, që këto të theksohen, nuk ka metodologji për biseda me njerëzit, andaj duhet të bisedohet se a do apo nuk do populli që të mundësohet hulumtimi.

Pal Lekaj- Tha se sa i përket këtyre rekomandimeve kisha për t'u pajtuar sikurse këto rekomandime të shkojnë të Qeveria, jo në Parlament, sepse Qeveria duhet paraprakisht t'i kryej këto dhe të vije në Parlament, te ne, që ta kemi shumë të qartë ta votojmë. Askush prej nesh nuk është kundër investimeve sepse janë të duhura. Vetëm nëse marrim pikën e parë ku lë dilema edhe tek unë edhe te të tjerët. Po e citoj sipërfaqja për eksplorim eventualisht për eksploitim, mirëpo lind pyetja ai që shpenzon mjete për eksplorim a mundesh me ja ndaluar, nuk ka gjasë teorike deri sa ai e merr përsipër dhe kjo është vetëm një huti te deputetët dhe këtë duhet ta bëjmë të qartë. Nëse kalojmë në pikën dytë që thuhet Qeveria obligohet që në kuadër të

procedurave të mëtutjeshme për të negociuar zbatimin eventual të projektit të hartojë studimin e fizibilitetit, çka është kush e bënë studimin e fizibilitetit kompania a qeveria. Studimin e fizibilitetit ne ende nuk e kemi dhe ta procedojmë në Kuvend që lenë dy kuptime dhe në këtë drejtim unë mendoj se duhet këto dilema të hiqen krejt. Pastaj të procedohet në Kuvend dhe të kemi një qartësim të plotë nga Qeveria më të gjitha këto të dhëna. Unë jam për, pastaj të votohet në Kuvend, mirëpo jo në këtë formë që ne e kemi.

Kryetari sqaroi se këtu është fjala se ne obligojmë Qeverinë, që ajo vetë të bëjë fizibilitetin. Natyrisht që asnjë kompani nuk hyn në investime të mëdha pa bërë hulumtim për fitimin e vetë. Ne kërkojmë që Qeveria ta bëjë studimin për vete, d.m.th. Qeveria ta kryej studimin për vete në mënyrë që t'i shoh kostot dhe përftimet jo vetëm ekonomike, por edhe sociale. Kjo është metodologji standarde që bëhet me të gjitha projektet dhe është shumë e qartë.

Enver Hoti- Tha se së paku është dashtë të ceket se vendimi i Qeverisë nuk është miratuar në Komision, në mbledhjen e kaluar të komisionit së paku të vendoset. Këto rekomandime që shkojnë sigurisht edhe në Kuvend, ku shumicën do t'i vë në lajthitje. Ju keni propozuar me arsyetim se vendimi i Qeverisë duhet të miratohet duke marrë parasysh edhe këto rekomandime. Ne kemi një përvojë se këto rekomandime, të gjitha ato vendime që i ka nxjerrë Kuvendi asnjëherë Qeveria nuk i ka zbatuar. Kjo është ajo që ne nuk mund ta përkrahim për mos me marr kohë më tepër për t'i arsyetuar të gjithë plotësisht se ky vendim i Qeverisë duhet t'i kthehet Qeverisë dhe të mos rekomandohet miratimi i tij në Kuvend.

Blerim Grainca- Tha se në parim po pajtohem të gjithë që jemi për investime edhe ne edhe Qeveria të gjithë aktorët kryesorë jemi për rritje të investimeve, mirëpo, unë jam në mes të dy propozimeve që u dhanë këtu. Propozoj që rekomandimet të mos bien në nivel të rekomandimeve, por t'i propozojmë Kuvendit të marrë vendimet për disa nga çështjet që janë këtu. Për çështjet që lidhen me fizibilitetin dhe në kuadër të cilit të hyjë eksplorimi, të obligohet qeveria që para nënshkrimit të marrëveshjes, të bëjë studimet e fizibilitetit ku hyjnë të gjitha elementet edhe mjedisi, kostot financiare dhe të gjitha të tjera, të marrë vendim Kuvendi dhe ta obligojë Qeverinë sidomos për pjesën komerciale të projektit. Nuk mjafton të themi garancitë financiare, neve na duhen informata të sakta. Në mbledhjen e kaluar i kam parashtruar ministrit pesë pyetje dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje! Prandaj kërkoj që Kuvendi të marrë vendim që ta obligojë Qeverinë që të sigurojë garancime financiare të mjaftueshëm. Mos të na ndodh si dytri projekte që na kanë dështuar, për arsyeje se kompania në fjalë është kompani që është regjistruar në vitin 2013 d.m.th. i kam thënë ministrit, është kompani pasive në Ministrinë e Tregtisë nuk ka asnjë projekt të kësaj natyre, backgroundin e ka zero kompania Envidity, nuk e ka asnjë lidhje me kompaninë Envidity në Kanada. Unë kërkoj që të futen vendime katër pika që lidhet me procesin teknik sepse duhet ta studiojmë në aspektin teknik, dhënia e licencës për hulumtime z. kryetar me automatizëm nëse kompania konstaton se ka rezerva dhe i plotëson disa kriteret shumë të thjeshta je i obliguar t'ia japësh licencën për shfrytëzim nëse i plotëson kriteret dhe konstaton se ka rezerva, ti nuk mundësh me refuzuar, se nuk ke arsye. T'i sqarojmë këto çështje ta bëjmë si vendim dhe ta procedojmë në kuvend.

Visar Ymeri: Në momentin që miraton licencën për hulumtim në bazë të projektit që ka propozuar Qeveria na ka treguar se çfarë do të bëjë Envidity me hulumtim edhe nëse i gjen resurset e mjaftueshme se çfarë do të bëjë me atë thëngjill. Ne nuk mund të bëhemi sikurse nuk

po e dimë sepse po e dimë, çka na duhet të diskutojmë, se a është e gatshme ta ofrojë Kosova edhe çfarë përfitime do të ketë Kosova. Përsëri po them, është e pa kuptimtë se një njeri ose një grup njerëzish ta konstatojnë se ka interes publik pa qenë të informuar, na nuk kemi kurrfarë informate me konstatuar se ka interes publik. Pra, së pari duhet ta kuptojmë një gjë se këtu u fol për investime. Jo, secili investim e ka ndikimin e njëjtë pozitiv në ekonominë e vendit, ka edhe investime që mund ta kenë ndikimin negativ edhe kjo duhet për t'u konstatuar se po flasim për investime të huaja. Pra, a po do Kosova me u drejtuar në këtë drejtim ekonomik se në momentin që miraton projekte të tilla si çështja e Envidity edhe Sharcemi atëherë ky është plan ekonomik afatgjatë për Kosovën, nuk janë investime në prodhim që do ta rrisnin bazën industriale të vendit e që do ta përmirësonin bilancin tregtar, e që do të punësonin njerëz prej krejt këtij projekti siç thuhet do të punësojë 80 vetë, ky qenka përfitimi ekonomik, a çka do të marrim ne, vetëm prej tantumës në thëngjill, prej tatimeve të korporatave që është 10% çka do të përfitoj Kosova nga kjo, a çka do të humbë, e humb një basen të thëngjillit e rrezikon mjedisin, nuk mundemi mu sjell sikur kjo nuk do të ndikoj në mjedis, nuk do të ndot dikë tjetër, profesor, kjo është djegie e brendshme. Them më së buti se ky komision dhe Kuvendi nesër nuk e di a do të ketë interes publik, si mund të konstatohet interesi publik në këtë rast kur ky rast, ta zëmë nëse studimi i fizibilitetit na tregon se ky rast ka me shkatërruar mjedisin e Kosovës, ose ka me zhvendos gjysmën e popullatës së Dukagjinit, si ta dimë ne këtë, ne nuk e dimë sot. Ky qenka interesi publik a? Unë mendoj se këto vendime, ky konstatim që ka bërë Qeveria duhet të kthehen mbrapa nga Kuvendi me thënë se nuk kemi mundësi ta konstatojmë një gjë të tillë kur t'i kompletosh informata, eja prapë në Kuvend dhe flasim nëse qenka në interes publik të Kosovës. Tash nuk mund as të flasim se a është në interes të Kosovës, për mua personalisht nuk është në interes fare të Kosovës edhe për ata që mendojnë se investimet e tilla duhet të jenë interes publik aktualisht nuk mund ta thonë një gjë të tillë pasi që nuk janë të informuar.

Kryetari: Prapë po them të mos i ndërrojmë tezat, këtu është konstatuar interesi publik për t'i bërë hulumtimet asgjë më shumë. A do të ketë interes publik për shfrytëzim do të konstatohet në bazë kësaj që kemi kërkuar ne. Unë jam dakord që këto që e tha Blerimi edhe vetë kam menduar që ne këto pak obligime do të jenë më të forta për Qeverinë vetëm të kthehen në gjuhën juridike, përndryshe pajtohem se tani që këto me qenë vendime të Kuvendit në disa pika edhe këtë e aprovojmë. Dhe e treta mendoj që këtë që e tha Duda Balje është e mirë kemi mundësi me qenë më preciz d.m.th. bazë metodologjisë dhe të bëhen konsultime gjithashtu të bëhen d.m.th. të komuniteteve që janë atje, metodologjia mu përdorë dhe të bëhen konsultime gjithanshme të komuniteteve. Do të ndodh ajo që vendos Kuvendi. në qoftë se ju mendoni se ai Kuvend nuk është dinjitar, nuk e di pse po vini në atë Kuvend edhe përpikuni që ta bëni kuvendin dinjitar ju lutem që kuvendi të jetë aq dinjitar sa ne jemi dinjitar. Dinjiteti i Kuvendit fatkeqësisht për sjelljen e shumë njerëzve aty është rreziku, andaj ne duhet t'ia kthejmë atij dinjitetin. Nuk po hedhin të gjithë atje gaz dhe gjësende. Prandaj propozoj të lëshohet edhe një pikë që të jetë vendim i Kuvendit që para marrëveshjes për shfrytëzim Qeveria obligohet të sjellë vendimin për shqyrtim dhe aprovim në Kuvend. Me këto përmirësime unë e propozoj ta aprovojmë.

Pas debatit, Komisioni me 5 (pesë) vota për, dhe 2 (dy) abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I. Kuvendi i Kosovës të miratojë propozimin e Qeverisë nr. 05/105, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC, ku Qeveria dhe KPMM, obligohen të sigurojnë se:

- (1) Sipërfaqja për eksplorim dhe eventualisht për eksploatim më vonë duhet të jetë e definuar dhe brenda kornizave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Miniera dhe minerale, Ligjin e Planifikimit Hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;*
- (2) Kuvendi të marrë vendim që Qeveria të obligohet që në kuadër të procedurave të mëtejme për të negociuar zbatimin eventual të projektit të hartojë studimin e fizibilitetit për këtë projekt, i cili do të definojë qartë kostot dhe përfitimet ekonomike dhe sociale, shanset që afron projekti dhe rrisqet eventuale dhe mundësitë e menaxhimit të tyre, sidomos lidhur me aspektet teknologjike, mjedisore (ujërat nëntokësore etj.) dhe ato të zhvillimit urban dhe koston oportune të projektit lidhur me ridestinimin e sipërfaqeve bujqësore dhe eventualisht zhvillimin e turizmit;*
- (3) Studimi i fizibilitetit duhet të përcaktojë qartë ndikimet potenciale të projektit, efektet e jashtme sociale e ekonomike në zhvillimin hapësinor dhe urban, duke marrë parasysh afërsinë me zonat urbane dhe të banimit, efektet në vendbanime dhe zhvendosje të popullatës dhe në ujërat nëntokësore;*
- (4) Patjetër, paraprakisht duhet të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor sipas metodologjisë së Bankës Botërore, si dhe të zbatohet një metodologji e standardeve të kësaj banke dhe të bëhen konsultime të gjithanshme me komunitetin lidhur me industrinë ekstraktive për këtë projekt;*
- (5) Kuvendi të marrë vendim se duhet të definohet qartë procedura e shpronësimeve, si në fazën e hulumtimeve gjeologjike dhe pastaj eventualisht edhe për fazën eksploatimit në mënyrë që kjo të mos bjerë në barrë të buxhetit qendror;*
- (6) Të sigurohen garancitë e nevojshme financiare;*
- (7) Qeveria ta mbajë të informuar Kuvendin lidhur me zhvillimet në zbatimin e këtij projekti;*
- (8) Para marrëveshjes eventuale për realizimin e projektit të shfrytëzimit, Qeveria obligohet të sjellë vendimin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.*

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Kryetari: Tani e kemi kërkesën e kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika, mendoj janë të njëjtat konstatime si në rastin e parë në përjashtim se i kemi korrigjuar. Hapi diskutimin.

Blerim Granica- Tha se kryesisht janë të njëjta me parimet që morëm edhe me kompaninë paraprake, nuk ka këtu studimi ndonjë thellësi, është një projekt më i prekshëm, më praktik. Prandaj mendoj se duhet të mbështetet ju siguroj që të dy kompanitë, më sa unë kam parë, kanë

aplikuar për zonën e njëjtë, prandaj te rekomandimet duhet t'i rekomandohet Komisionit për Miniera që të shikojë mundësinë që të mos ketë dualizëm ose probleme.

Raif Qela: Te kjo kompani është akoma më klasike metoda e shfrytëzimit të energjisë së Kosovës, por jo për Kosovën, se sa në projektin e parë. Megjithatë, për kundër faktit që janë shumë të panjohura dhe për këtë, përpara së të miratohet projekti, mendoj se duhet të jenë të njëjtat konkulza si për projektin e parë.

Kryetari: Unë nuk kam asgjë kundër, vetëm po marrim mendime se ky projekt ka dimension tjetër edhe kërkojmë fizibilitetin dhe të gjitha paraprakisht para eksplantimit, nuk mendoj se na duhet, ky është projekt relativisht i vogël. Raif, nuk besoj se ka ato dimensione dhe është interesi jonë më kursyer energjinë, me shfrytëzuar këtu. Nuk shfrytëzohet jashtë Kosovës, shfrytëzohet në Kosovë, më shumë mundet me u shfrytëzuar edhe në Mal të Zi, edhe në fabrikat e çimentos. Unë mendoj se këto nuk i kemi të ndërlikuara. Ajo është teknologji e re, e avancuar, ka shumë pikëpyetje. Prandaj unë i arsyetoj rigorozitetin që nuk e kemi diskutuar.

Pal Lekaj: Prapë po insistoj se çfarëdo vendimi që do të bjerë keni për të pasur probleme në të ardhmen, sepse unë kam qëndruar në hapësirën ku këta po dëshirojnë me shfrytëzuar qymyrin. Janë të gjitha toka pjellore që i përket një komuniteti që quhet Lugu i Drinit, që të jeni të bindur se ka me pasur pasoja dhe nuk ka me qenë e implemtuar. Prandaj është shumë lehtë sikur ne ta kishim pronën tonë aty edhe vendosim ndryshe kishim vendosur dhe prapë ju paralajmëroi sikur për gjëra tjera që ju i keni marrë me lehtësi dhe tani jemi ku jemi, prapë po ju lajmëroj që jeni duke gabuar shumë rëndë sepse është komuniteti i Lugut të Drinit dhe, ai komunitet nuk ka investime dhe tani do t'ia merrni edhe atë tokë. Prandaj keni kujdes, po ju paralajmëroj se nuk ka me mundur me implementuar. Vetëm po ju paralajmëroj.

Kryetari: Nuk mendoj se kemi nevojë për kërcënime dhe paralajmërime, mendoj se duhet të vendosim.

Pal Lekaj: Nuk është kërcënim, vetëm po paralajmëroj se do të ketë probleme.

Kryetari: Nuk keni nevojë me kërcënuar askënd, se ne jemi të rritur, i kemi 18 vjet, dimë për vendime tona. Kërko falje për mënyrën si u solle. Unë kam të drejtë këtu! Unë e udhëhiqi mbledhjen jo ti, një votë ti, një votë unë. Mirëpo unë e udhëhiqi mbledhjen.

Pal Lekaj: Nuk ke asnjë të drejtë më të mëdhe se sa unë, të gjithë jemi të barabartë.

Kryetari: Mos t'i politizojmë gjërat, interesi i qytetarëve është për investime, pajtohem me Palin, se shoqëria duhet me ditur se a është interesi më i madh ekonomik për këto sipërfaqe, për këtë investim apo për bujqësi, për atë po e bëjmë studimin e fizibilitetit. Nuk jemi duke u sjellë nën çdo nivel. Dhe mendoj se pikën 2, ne duhet të themi se Kuvendi vendos që Qeveria studimi i fizibilitetit me treguar për atë që po e thotë Pali. Se sa është kosto oportune që humbën tokën se çka po përfitojmë, sa veta punësohen, por para eksplantimit duhet kjo të bëhet. Prandaj atë që ki të drejt po, ne po mundohemi të diskutojmë herën e kaluar, nuk kemi nevojë me denigruar njëri-tjetrin.

Visar Ymeri: Edhe pse janë të ngjashme këto dy projekte ka edhe disa dallime të Sharrcemi është vetëm metoda, edhe qëllimi afarist që e ka “Sharçemi” që është i ndryshëm prej Envidity, këta kanë kërkuar edhe drejtpërdrejt licencë për shfrytëzim. D. m. Th. kur thuhet se ka kërkuar licencë për shfrytëzim që ka kërkuar këtë, ka kërkuar licencë për hulumtime, licencë për hulumtim do të kërkojnë tani, tani kanë kërkuar për shfrytëzim. Pra, është diskutimi i njëjtë kur flasim dhe këtu i shtohet kjo që tha Pali që po flasim për një komunitet të njerëzve të cilët ekonominë jetësore e kanë bujqësinë. Edhe në këtë drejtim mendoj që këtu në fakt po për lidhet një diskutim jashtëzakonisht i rëndësishëm që duhet të bëhet në Komisionin për Zhvillimin Ekonomik, por gjithandej në opinionin publik se çfarë ekonomie do të zhvillojmë në Kosovë, edhe ky konstatim se premtoi qeveria se interesi publik me këtë na tregoi se çfarë ekonomie do të ndërtojë Qeveria e kjo është ekonomi nxjerrëse, që nxjerrë resurset edhe i shet në këtë rast është ende më e dhimbshme se ti e nxjerr thëngjillin dhe e shet. Pra, më herët qeveria në planin e saj për energjetikë dhe strategjinë flitet për themelimin e kompanisë së thëngjillit, korporatë publike që e ka në shfrytëzim dhe që e trajton thëngjillin e Kosovës edhe tash kësaj korporatë publike të thëngjillit kemi menduar dhe jemi pajtuar për ta krijuar po ja marrim thëngjillin dhe pastaj mbetet vetëm korporatë publike d.m.th. unë nuk po shoh kurrfarë logjike ekonomike e lëre më tjetër në këto vendime që na ka sjellë Qeveria. Prandaj, mendoj njëjtë si në të kaluarën se as nuk ka interes publik, as nuk ka mundësi me konstatuar interesin publik me informatat që i kemi e as më pak tani me miratuar. Nëse Kosova nuk e bën tani këtë diskutim për një strategji afatgjate ekonomike ku po duam të shkojmë kemi për të përfunduar shumë më keq se ku jemi, këto janë vendime. Ka kërkuar një kompani, hajde tani turr ja jepni asaj se po investon. Çfarë para po investon, çka kush ka me përfituar për këto investime, s’është projekt se po punëson shumë njerëz, nuk kemi nevojë me prituri dhe me na treguar Qeveria se ka me i punësuar 80 apo 100 njerëz, e dimë tani se sa njerëz ka për t’i punësuar ky lloj aktiviteti, e dimë tani se çfarë dëmi do t’i shkaktojë mjedisit ky projekt, e kemi mihjen e thëngjillit shumë afër Prishtinës. Nëse kemi ndonjë dilemë se çfarë i bënë kjo ujit e tokës bujqësore, mundemi për të shkuar ta shohim. Mos të bëhemi se nuk e dimë, ne mund të shkojmë ta shohim. Mirëpo për ta konstatuar interesin publik mendoj se po bëjmë një vendim shumë të madh ndaj Republikës të Kosovës, nëse kjo kalon.

Enver Hoti: Edhe një herë po e marr fjalën se nuk po lidhet shumë se e kemi përfunduar mbledhjen e kaluar, por duhet ta ngriti edhe një herë dilemën që e thashë. Është për t’u habitur se kemi një vendim të Qeverisë se ka të panjohura, se ka rreziqe, dhe jemi pajtuar të gjithë dhe kemi nxjerrë disa rekomandime. Ne kemi rastin dhe këtu po flasin disa deputetë, po flasin disa fjalë të mira, na japin ide të mira, por dorën e ngritin për atë që është e megjullt, çka është ndoshta shkatërruese për vendin, kjo ka për të ndodhur edhe në Kuvend. Profesor, unë po të kuptoj se ndoshta je edhe në presion se nuk po mund të dalësh anash vendimit të Qeverisë. Jam i brengosur për projektin e Qeverisë, jo për ty. Duhet ta ngriti se kjo gjendje edhe në parlament, se kjo kompani të marr licencën për hulumtim ia paftë hairin edhe për shfrytëzim, pasi që nuk e keni asnjë mekanizëm parandalues, nuk e keni për ta proceduar këtë projekt deri në fund të kësaj qeverie, këtu janë disa interesa të ngushta. Këtu vetëm po konstatoj se ju prapë kështu keni me tentuar me paraqitur interesin e vendin, ndërsa me ngritjen e dorës keni me marrë vendimin më të keq të mundshëm si ekonomist i njohur për vendin.

Kryetari: Fatkeqësisht ne, sot, këtu në vend që të flasim për përmbajtjen, ne po bëjmë një retorik thjesht politike se dikush vendos kështu, dikush kështu dikush qenka i ndërgjegjshëm po

vendoska ndryshe. Prandaj, ju lutem i refuzoj gjuhën e tillë dhe mënyrën e tillë të konstatimit, gjithçka e kam shkruar kështu është në ndërgjegjen më të lartë profesionale që kam shkruar këtu. Edhe besoj se konkulza më rigorozë për ta konstatuar interesin publik nuk është marrë deri sot, edhe ma të qarta nuk janë marrë deri sot. Prandaj, thellohu në këto që po bëjmë e mos të bëjmë këtu retorikë thjesht politike pa fokusuar në përmbajtje. Ky projekt u tha këtu e ka një arsyeshmëri, arsyeshmëria i ka rrisqet e veta, prandaj po kërkojmë rigorozitet në zbatimin e tij. Natyrisht se dimensionet e këtij projekti janë të tjera, por ndoshta në disa aspekte në mjedis përpos disa jo njohurive që kemi për gazin nëntokësor, ujërat, në aspektin mbiotokësor është më i rrezikshëm se sa i pari. Prandaj po kërkojmë rigorozitet. Sa i përket sipërfaqes bujqësore unë nuk e di sa do të dihet mbas licencës, duhet t'i jepet njëherë leja për hulumtim, për shfrytëzim edhe në qoftë se ajo tokë e ka studimin e fizibilitetit. Z. Lekaj d.m.th. toka bujqësore që ka për ta shfrytëzuar Sharcemi e ka këtë sipërfaqe, ajo sipërfaqe për 20 vjet jep këtë rendimet bujqësor përfitimet nga rendimenti bujqësor janë këto, kurse përfitimet nga djegia i këtij thëngjilli janë këto, dhe do t'i barazojë. Ajo është kostanaliza që duhet të ketë studimi fizibiliteti, prandaj nuk po luajmë, ne jemi në mënyrë serioze duke folur.

Visar Ymeri: Po flasim tema profesionale, është diskutuar për rreziqe, nuk dua të hyj andej a mundet që dikush me 2 fjali, 3 fjali, 2 orë sa do që ka nevojë të më shpjegoj ku është interesi publik këtu, se deri tani jemi duke treguar se si ka rreziqe të mëdha. Eja ta zëmë se nuk i kemi të konstatuara, ta zëmë se rreziqet nuk ekzistojnë. Ku është interesi publik?

Kryetari: Interesi publik është i përshkruar në vendimin e Qeverisë edhe me kërkesën e kompanisë kush nuk e ka lexuar ta lexoj.

Visar Ymeri: Pra, ju po vendosni se çfarë ka thënë kompania?

Kryetari: Jo kompania, po edhe Qeveria e ka verifikuar që ka thënë.

Visar Ymeri: Po ju pyes profesionalisht, ju a pajtoheni sa ka interes publik?

Kryetari: Unë nuk mund ta konstatoj atë, studimi i fizibilitetit do ta konstatojë. E ti qysh po e din që nuk është ashtu, qysh?

Visar Ymeri: Unë s'po them se nuk është ashtu. Unë po them: pa i pasur këto informata nuk e dimë, ti po thua se tani e di. Profesor, shiko vendimin që e miratove, në rekomandime ti e konstatove që ka interes publik që ka tani, po thua nuk e di. Cili është interesi publik?

Kryetari: Interesi për hulumtim dhe eksplorim të metaleve, shumë mirë e tha kolegja Sala Berisha Shala, se të interesi publik gjithmonë ekziston interesi për hulumtim.

Visar Ymeri: A tani po vjen kompania me treguar sa thëngjill kemi a? Nuk e paskam ditur, kishe e ka për përfitime.

Kryetari: Nëse nuk e ke ditur duhet ta mësosh, duhet ta mësojmë secili prej nesh. Diskutimi përfundoj, vetëm diskutime konkrete, pika konkrete se vetëm po i përsërisim, është duke u politizuar situata.

Pal Lekaj: Sa i përket seriozitetit të kësaj teme se çdo njëri jemi të vetëdijsëm dhe e kemi marrë me seriozitet duke analizuar dhe personalisht po ju them se kam qenë në atë fushë ku është interesuar edhe Sharcemi edhe kompania Envidity. Ajo që unë kam vërejtur dhe kam biseduar me pronarët ajo është tokë pjellore bujqësore e pëlleshme dhe nuk besoj se kanë për t'u dakorduar qytetarët për diçka të tillë. Dhe po më habit fakti nëse kemi një mendim ndryshe duhet të jemi tolerant sikur ne jemi tolerant dhe ju dëgjojmë me vëmendje. Nëse thoni se nuk kemi fizibilitet nuk kemi të dhëna nuk kemi analizuar dhe të votojmë diçka. Prapë po insistoj për diçka se nuk e dimë se a është gjithçka në hapësirë dhe kjo po e them se ka për ta qitur në lajthitje Kuvendin, prapë sikur investime të tjera, sikur vendime tjera dhe Qeveria dhe Komisioni ka për ta kryer të veten dhe më kurrë nuk do ta shihni në Kuvend. Ne nuk jemi kundër investimeve, por jemi kundër asaj që të analizohet, do të thotë që të mos bjerë diçka në Kuvend pa e ditur se çka po votojmë kjo është.

Kryetari: Ju lutem më vjen shumë keq që më pari duhet shumë shpesh të lidhem me aspekte teknike dhe profesionale. Studimi i fizibilitetit për t'u bërë, duhet të ekzistojnë hulumtimet paraprake gjeologjike, studimi i fizibilitetit duhet të bazohet në të. Prandaj nuk mundemi me diskutuar, ju lutem! Ju kam thënë urdhëroni në Kuvend, çështjet në Komision të mos i politizojmë këto sende, kur të shkojmë në Kuvend bëni çka të doni luftë politike partiake. Ju lutem të jemi ku është interesi nacional, mos t'i mbyllim derën për investime, në këtë drejtim unë mendoj se këtu duhet të them se Kuvendi të vendos që Qeveria të obligohet të bëjë studimin e fizibilitetit para marrëveshjes për eksploatim, edhe pse është projekt i vogël nuk e di a kemi nevojë a jo?

Sala Berisha- Shala: E para po me vjen mirë se opozita është kthyer në Kuvend dhe po debatojmë, po e analizojmë mundësin alternativat se qysh është më mirë për qytetarin e Kosovës. Kjo është një hap përpara. Sa i përket kësaj pike tani unë dua ta shprehi një rezervë për lejen, për veprimtarin nxjerrëse, jo përpunuese. E kemi një përvojë, po u a rikujtoj një përvojë të hidhur me Ferronikelin që është duke krijuar veprimtari vetëm nxjerrëse që po e shet në Kavadac. Prandaj për këtë pikë jam e rezervuar në votim. Tjetër, unë ju ftoj kolegë deputetë, jemi në fazën e monitorimit të Ligjit për Miniera dhe Minerale. Ju ftoj ta analizoni mirë të gjithë që jeni edhe kundër kësaj edhe pro kësaj dhe ejani bashkë t'i shohim zbrazëtit, mundësitë mbas monitorimit është edhe fillimi i fazës së plotësim -ndryshimit të ligjit. Në qoftë se të gjitha këto veprimtari që lidhem me pasuritë nëntokësore do të shkojnë konform ligjit. Ne s'duhet t'i frikohemi asnjë projekti, asnjë oferte të tillë, kaq kam. Nesër e kemi dëgjimin publik, ju ftoj! Jemi të gjithë kompetentë për këtë. Ju lutem më lejoni të përmbahem në votën time për këtë pikë.

Blerim Grainca: Kryetar, unë kam një propozim pak më konkret, te rekomandimet thuhet se Kuvendi i Kosovës, miratim- propozimin e Qeverisë konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës, ne duhet ta bëjmë për hulumtim. Kështu qysh është lënë mund të jetë edhe për shfrytëzim. Ne duhet ta definojmë.

Raif Qela: Të nderuar deputetë, ashtu siç e propozova më herët them se në rekomandime të futet si edhe në projektin e parë, se ky projekt pas studimit të fizibiliteti, të vijë në Kuvend për miratim ose jo të projektit për shfrytëzim, vetëm si të tillë unë e pranoj. Për derisa sa dy kolegë

deputetë më përmenden në kontekstin negativ, jam shumë i vetëdijshëm se në atë se çfarë e jap votën për, e jap votën për vetëm atëherë kur u siguroam që po japim të drejtën, lejen vetëm të vazhdojë në hulumtim dhe para shfrytëzimit, pas studimit të fizibilitetit do ta shqyrtojmë prapë. Deri atëherë kërkoj edhe prej deputetëve të Kuvendit që të kërkojmë informacion sa më shumë, në mënyrë që të jemi të sigurt se çfarë po votojmë, në qoftë se ky projekt vazhdon çështjen edhe për shfrytëzim.

Kryetari: Po ashtu është për hulumtim edhe te i pari ta bëni për hulumtim, ju lutem t'i korrigjoni vendimet edhe te pjesa e parë, i shtohet fjala licenca për hulumtim.

Pas debatit, Komisioni me 5 (pesë) vota për, dhe 3 (tri) abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I. Kuvendi i Kosovës të miratojë propozimin e Qeverisë nr. 05/106, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik për lëshimin e licencës për hulumtim për Projektin e Kompanisë Sharr Cem dhe Titan Amerika, ku Qeveria dhe KPMM, obligohen të sigurojnë se:

- (1) Sipërfaqja për eksplorim dhe eventualisht për eksploatim më vonë duhet të jetë e definuar dhe brenda kornizave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Miniera dhe minerale, Ligjin e Planifikimit hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;*
- (2) Kuvendi të marrë vendim që Qeveria të obligohet që në kuadër të procedurave të mëtejme për të negociuar zbatimin eventual të projektit të hartojë studimin e fizibilitetit për këtë projekt, cili do të definojë qartë kostot dhe përfitimet ekonomike dhe sociale, shanset që afron projekti dhe rrisqet eventuale dhe mundësitë e menaxhimit të tyre, sidomos lidhur me aspektet teknologjike, mjedisore dhe ato të zhvillimit urban dhe koston oportune të projektit lidhur me ridestininimin e sipërfaqeve bujqësore dhe eventualisht zhvillimin e turizmit;*
- (3) Studimi i fizibilitetit duhet të përcaktojë qartë ndikimet potenciale të projektit, efektet e jashtme sociale e ekonomike në zhvillimin hapësinor dhe urban, duke marrë parasysh afërsinë me zonat urbane dhe të banimit, efektet në vendbanime dhe zhvendosje të popullatës;*
- (4) Patjetër, paraprakisht duhet të bëhet vlerësimi strategjik mjedisor sipas metodologjisë së Bankës Botërore, si dhe të zbatohet një metodologji e standardeve të kësaj banke dhe të bëhen konsultime të gjithanshme me komunitetin lidhur me industrinë ekstraktive për realizimin e këtij projekti;*
- (5) Kuvendi të marrë vendim se duhet të definohet qartë procedura e shpronësimeve, si në fazën e hulumtimeve gjeologjike dhe pastaj eventualisht edhe për fazën eksploatimit në mënyrë që kjo të mos bjerë në barrë të buxhetit qendror;*
- (6) Të sigurohen garancitë e nevojshme financiare;*
- (7) Qeveria ta mbajë të informuar Kuvendin lidhur me zhvillimet në zbatimin e këtyre projekteve;*

(8) *Para marrëveshjes eventuale për realizimin e projektit dhe shfrytëzimin e linjitet, Qeveria obligohet të sjellë vendimin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.*

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

5. Aprovimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2016 dhe prioritetet e Komisionit për sesionin vjeshtor 2016

Kryetari: Lidhur me Raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror 2016 dhe prioritetet e Komisionit për sesionin vjeshtor 2016, tha që deri tani Komisioni ka punuar në bazë të Planit vjetor për vitin 2016, ku ka zhvilluar shumë aktivitete dhe e ka realizuar planin për sesionin pranveror 2016. Propozoi që në prioritetet e Komisionit për sesionin vjeshtor 2016 të bëhen disa ndryshime të vogla si vijon: Projektligji për Trepçën të kalojë nga muaj shtator në muajin tetor, Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburantet e ripërtërime të kalojë nga muaji shtator në muajin nëntor; Mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore të Ministrive të linjës dhe Agjencive të pavarura, që gjatë muajit tetor të ftohën të gjithë ministrat për raportim. Kërkoj të shtohet edhe një pikë në planin e punës për sesionin vjeshtor 2016, që si prioritet të jetë edhe bashkëpunimi ndërkombëtar, në këtë rast të ftohet Komisioni homolog nga Republika e Shqipërisë.

Sala Berisha-Shala- Tha se në vend të “mbikëqyrja e shpenzimeve buxhetore” të thuhet “mbikëqyrja e realizimit të projekteve”, pasi që mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore e bënë Komisioni për buxhet.

Me këto propozime u pajtuan anëtarët Komisionit.

Pas diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për sesionin pranveror 2016, dhe ndryshim- plotësimi i Planit të punës për vitin 2016.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari- Tha sot kemi vizitë në terren, në KOSST, si dhe e njoftoi Komisionin se nga nesër do të udhëtojë në Nju Jork, ku është ftuar nga bizneset shqiptare në Amerikë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa